VENDIM
Nr. 226, datë 26.10.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENER TRADE" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa "e"; të nenit 5, pika 1, germa "e" dhe nenit 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 628, datë 3.10.2018, shoqëria "Ener Trade" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 220, datë 11.10.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, u publikua në media njoftimi me nr. 55/61 prot., datë 11.10.2018. Po ashtu, me shkresën nr. 628/2 prot., datë 16.10.2018, iu kërkua subjektit plotësimi i dokumentacionit të munguar që kishte të bënte me nenin 9, pika 2, germa "d" (Vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata), për shoqërinë "Ener Trade" sh.p.k.
- Subjekti, me shkresën nr. 628/1 prot., datë 15.10.2018, ka paraqitur në ERE dokumen-tacionin e munguar cituar më sipër.
- Aplikimi i shoqërisë "Ener Trade" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2): plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.8): plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Ener Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti